



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 2 dhjetor 2013
Nr.ref.:RK509/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 79/12

Parashtrues

Tanasko Djordjević dhe të tjerët

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Mlc Rev. 377/2009, të 8 majit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Tanasko Djordjević, znj. Milorotka Jelić, z. Srboljub Djordjević, znj. Serafina Djordjević, znj. Jagoda Janković dhe z. Milorad Djordjević nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson z. Bashkim Nevzati, avokat nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është i Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Mİc Rev. 377/2009, i 8 majit 2012, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 12 korrik 2012, me të cilin është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe është hedhur poshtë padia e parashtruesve për anulimin e kontratës mbi faljen e patundshmërive të përfshira në kontratën mbi falje, Leg. Nr. (Posl. Br. Ov.) 956/59, i 7 tetorit 1959, e lidhur në mes paraardhëses të paditësve si dhuratëdhënës dhe Komunës së Prizrenit, në cilësinë e dhuratëmarrësit.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Mİc Rev. 377/2009, i 8 majit 2012, duke pretenduar se është shkelur neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 24 gusht 2012.
6. Më 27 shtator 2012, Gjykata Kushtetuese e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesve të kërkesës dhe Gjykatën Komunale në Prizren, Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe Gjykatën Supreme të Kosovës se është iniciuar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë të vendimeve në lidhje me rastin nr. KI79/12.
7. Me Vendimin e Kryetarit (Nr. GJR. 79/12, të 4 shtatorit 2012), gjyqtari Ivan Čukalović u emërua Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me vendimin e Kryetarit, nr. KSH. 79/12, u emërua Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani, anëtarë të kolegjit.
8. Më 19 nëntor 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 7 tetor 1959 është lidhur kontrata Leg. nr. 956/59 mbi dhuratën në mes të Jovanka Miletic Dejanovicit, nga Prizreni, si dhuratëdhënës, në njërin anë, dhe atëbotë Këshillit Popullor të Komunës së Prizrenit, si dhuratëmarrës, nga ana tjetër, sipas së cilës, dhuratëdhënësi i dhuroi dhuratëmarrësit parcelat kadastrale: nr. 4/168/2 në sipërfaqe prej 0.47,00 ha; nr. 5/229 në sipërfaqe prej 0.30,00 ha; nr. 5/236 në sipërfaqe prej 0.92,00 ha; dhe nr. 5/316 në sipërfaqe prej 0.38,00 ha në zonën kadastrale të Prizrenit, të cilat kanë qenë të evidentuara në emër të paraardhëses së paditësve.
10. Kjo ngastër në bazë të kësaj kontrate kaloi në pronësi shoqërore në emër të Kuvendit Komunal të Prizrenit.
11. Ish-pronarja e paluajtshmërisë së përshkruar më lart ndërroi jetë më 15 mars 1967, duke lënë pas vetes Grozdana Djordjevićin, e cila po ashtu ka vdekur dhe ka lënë pas vetes si trashëgimtarë paditësit në gjykatat e rregullta, dhe të cilët në Gjykatë përfaqësohen nga parashtruesi i kërkesës.
12. Në një datë të paspecifikuar gjatë vitit 1997, trashëgimtarët e tashmë të ndjerës Jovanka Jovanović, kanë iniciuar në Gjykatën Komunale në Prizren, me anë të padisë, procedurë për anulimin e kontratës dhe për kthimin e pronës së paluajtshme, pasi kanë konsideruar se nënshkrimi i kontratës mbi dhuratën ishte bërë nën kërcënim dhe se nuk përfaqëson vullnetin e lirë të saj. Paditësit në këtë procedurë kërkuan nga Gjykata Komunale në Prizren rikthimin e pronësisë mbi parcelën kadastrale kat. nr. 5/316, e cila tani është e evidentuar në emër të KK Prizren si parc. kat. Nr. 2035, me sipërfaqe prej 0.38,67 ha, parcelës kadastrale 5/236, e cila tani është e evidentuar në emër të KBI "Progress-Export" nga Prizreni, dhe parcelës kadastrale parc. kat. nr. 5070, me sipërfaqe 0.94,74 ha, e cila evidentohet në emër të M.K.
13. Gjykata Komunale në Prizren pas shqyrtimit të provave dhe dëshmisë së dëshmitarëve, nxori Aktgjykimin C. Nr. 1067/97, të 12 dhjetorit 2007, me të cilin e pranoi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve dhe konstatoi se kontrata mbi dhurimin e paluajtshmërisë Leg. nr. 956/59, e 7 tetorit 1959, e lidhur në mes Jovanka Miletic Dejanovicit, nga Prizreni, si dhuratëdhënës nga njëra anë dhe Komunës së Prizrenit, si dhuratëmarrës nga ana tjetër, ishte e pavlefshme.
14. Në vendimin e saj, Gjykata Komunale në Prizren theksoi se:

“Gjykata i ka vlerësuar deklaratat e dëshmitarëve të cekur, sepse deklaratat e tyre në tërësi pajtohen dhe e vërtetojnë faktin se kontrata mbi dhuratën është lidhur me presion dhe nuk është shprehje e vullnetit të lirë të dhuratëdhënësit, andaj si e tillë është absolut nule. Në kuptim të Ligjit mbi qarkullimin e paluajtshmërisë, dhe i cili ligj është i aplikueshëm në Kosovë në kuptim të Rregullores nr. 1999/24”.
15. Brenda afatit ligjor, të paditurit (KK Prizren dhe KBI "Progress-Export") me ankesa të veçanta kundër këtij aktgjykimi iu drejtuan Gjykatës së Qarkut në Prizren duke *“atakuar të njëjtin për shkak të shkëlqeve esenciale të dispozitave*

të procedurës civile, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimi i atakuar të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim”.

16. Më 1 dhjetor 2008, Gjykata e Qarkut në Prizren duke vendosur sipas ankesës, nxori Aktgjykimin Ac. nr. 143/04, me të cilin i refuzoi si të pabazuara ankesat e të paditurve dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. Nr. 1067/97.
17. Gjykata e Qarkut në Prizren, në aktgjykimin e saj ndër të tjera theksoi se *“gjykata e shkallës së parë me vërtetimin e fakteve vendimtare drejt ka vendosur kur ka vërtetuar se kontrata mbi dhuratën, Leg. Nr. 956/59, është nule. Për këtë në aktgjykimin e shkallës së parë kanë dhënë arsyet bindëse me të cilat kjo gjykatë pajtohet në tërësi dhe i pranon si të tilla.”*
18. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Prokurori Publik i Kosovës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë *“për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim”.* Në të njëjtën kohë edhe Komuna e Prizrenit kishte paraqitur revizion *“për shkak të shkeljeve thelbësore të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të ndryshohen aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, ashtu që të refuzohet kërkesëpadia e paditësve ose lënda të priset dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.”*
19. Më 8 maj 2012, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin MIc Rev. nr. 377/2009, me të cilin gjeti se gjykatat e instancave më të ulëta gabimisht e kanë zbatuar të drejtën materiale dhe ndryshoi aktgjykimet e këtyre gjykatave.
20. Në pjesën e arsytimit të aktgjykimit të saj, Gjykata Supreme theksoi se:

“Kontrata e dhurimit, e cila është lidhur më 30 shtator 1959, siç shihet dhe nga fotokopja e kontratës që ndodhet në shkresat e lëndës, dhe në rastin konkret nuk mund të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi marrëdhëniet detyrimore, i cili ka hyrë në fuqi më 1 tetor 1978, dispozitat e të cilit sipas nenit 1106 të këtij ligji, nuk do të zbatohen në marrëdhënie detyrimore para hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

[...]

“Edhe po të supozohet që të ketë pasur mungesë të vullnetit të palës kontraktuese për shkak të kërcënimit, lajthimit apo mashtrimit, sipas rregullave të së drejtës civile, kontrata e tillë do të ishte relativisht e pavlefshme, dhe se anulimi i kontratës për arsye të tilla mund të kërkohej në afat prej një viti nga dita e marrjes në dijeni të shkakut të rrëzueshmërisë, pushimit të shkakut të kërcënimit, ndërsa e drejta e tillë humbet në afatin objektiv prej tri vjetësh”.

[...]

“Për faktin se kanë kaluar të gjitha afatet për kërkimin e nulitetit relativ të kontratës, të cilat afate janë prekluzive, në rastin konkret nuk mund të kërkohet nuliteti i kontratës pas skadimit të afatit prej mbi 38 vjetësh, siç kanë vepruar paditësit në rastin konkret”.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

21. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, MIc Rev. nr. 377/2009, të 8 majit 2012, duke pretenduar se *“në bazë të nenit 54. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose të mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.*
22. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme përmes MIc Rev. nr. 377/2009, ka shkelur nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, i cili thekson se çdo person fizik dhe juridik ka të drejtë ta gëzojë pronën e tij dhe se askush nuk mund të privohet nga prona e tij.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kriteret e kërkuara për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tutje me Ligj dhe me Rregulloren e punës të Gjykatës.
24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 (7), që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe liritë të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjithamjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

25. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij/saj të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

26. Për më tepër, rregulli 36 (1) c) dhe (2) a) dhe b) i Rregullores së punës, parasheh:

“(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

c) Kërkesa është qartazi e bazuar.

[...]

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) *Kërkesa nuk arsyetohet prima facie;*

b) *faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.*

27. Në këtë rast, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kontestojnë vendimin e Gjykatës Supreme, me të cilin pretendojnë se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente ndërkombëtare, si pasojë e konstatimit të gabuar të fakteve dhe aplikimit të gabueshëm të ligjit nga Gjykata Supreme.
28. Pas shqyrtimit të rastit në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, Shub vs. Lithuania, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
29. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është gjykatë e shkallës së katërt, kur i shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e instancave më të ulëta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
30. Parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur asnjë provë *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese (Shih, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005). Parashtruesit e kërkesës në asnjë mënyrë nuk e mbështesin kërkesën e tij se janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 46 të Kushtetutës.
31. Prandaj, Gjykata gjen se kërkesa e parashtruesve nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë, sepse parashtruesit kanë dështuar të provojnë se me vendimin e kontestuar i janë shkelur atij të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.
32. Në tërësi, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesve, në pajtim me rregullin 36.2 (a) dhe (b) të Rregullores së punës, është qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 20 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36.2 dhe 56.2 të Rregullores së punës, më 19 nëntor 2013, me shumicë votash:

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

